



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LIBRAZHDI
SEKTORI PROJEKTEVE , INVESTIMEVE , SHERBIMEVE DHE STREHIMIT

Adresa : Qyteti Librazhd Nr.Tel & fax. 0514 / 2352.

e-mail: librazhdbashkia@yahoo.com.

RELACION DHE SPECIFIKIME TEKNIKE
MBI PROJEKTIN
**"NDERTIM MINIPARKU PRANE ARGJINATURES DHE SISTEMIM I VEND-
DEPOZITIMIT TE MBETJEVE URBANE"**
BASHKIA LIBRAZHDI

Prane argjinaures , ne zonen midis perroit te Sigurimeve Shoqerore dhe perroit te Mojsjes eshte parashikuar ndertimi e nje Miniparku me nje siperfaqe rreth 30 000 m² (rreth 16000 m² gjelberim).

Zona ku do te ndertohet minipaku e qytetit Librazhd , ndodhet ne perendim te qytetit, kufizohet ne jug nga objekte private, perendim nga lumi Shkumbin , ne veri nga objekte te drejtorise se pyjeve,dhe ne lindje nga rruga e Dibres.

Objekti parashikohet te ndertohen te gjithë elementet te baze te nje parku si ; rrugicat lidhese me pllaka, ndricimin, gjelberimin , stolat, çezma publike, rethime te gjelberta, shkalle lidhese me pedonalen e argjinaures,rampa , nivelimi me dhe vegjetal i terrenit, sistem ujitje,piste vrapi, fusha sportive, etj.

Ne kete projekt, nisur nga fondi i vene ne dispozicion per financim, jane parashikuar vetem punimet per ndertimin e elementeve baze te nje parku, sic jane ndertimi i rrugicave me nenshtresat e saj, ndertim shkalle lidhese me pedonalen, linja kryesore e sistemit te ujitjes, tubo per ndricimin, ndertim çezme publike, ndertim konstruksione per mbrojtje nga perroi, mbjellje peme e shkurre decorative , mbjellje bari.

Zona ku do te ndertohet minipaku i qytetit Librazhd , ndodhet ne perendim te qytetit, kufizohet ne jug nga objekte private, perendim nga lumi Shkumbin , ne veri nga objekte te drejtorise se pyjeve,dhe ne lindje nga rruga e Dibres. Ka nje siperfaqe prej rreth 30.000 m².

Miniparku qe do te ndertohet eshte parashikuar te ndertohet i rrafshët . Ne kete terren jane pershtatur edhe elementët që përbëjnë sipërfaqet e gjelbra siç janë sheshe te pushimit, këndet dhe veprat panoramike, lëndinat me bar dekorativ, parcelat me lule, terrenet sportive, sipërfaqet dhe efektet ujore etj.

Modifikimi i terrenit dhe i veprave të tjera pjese perberese te parkut , jane projektuar me forma gjeometrike. Terreni eshte modifikuar vende-vende me forma konkave dhe konvekse per nje pamje më tërheqëse.

Meqenese sipërfaqja e gjelbër ndërtohet mbi mbeturinat e gërmadhve është parashikuar qe në këte territor të hidhet dhë i mirë vegjetal deri 30 cm trashësi.

Te dhenat e modifikimit te terrenit ku do të ndërtohet sipërfaqja e gjelbër jane paraqitur ne projekt, ne prerjet terthore

Modifikimi i terrenit eshte projektuar paralelisht me projektimin e sistemit rrugor,kanalizimeve, ujësjellësit ndriçimit rrugor, atij dekorative dhe të gjitha punimeve të tjera që lidhen drejtpërdrejt me zhvendosjen dhe lëvizjen e dherave.

Per shkak se terreni eshte pothuajse i rrafshet ,sistemi rrugor eshte parashikuar me forma gjeometrike, Pra me rruge te drejta kryesore dhe sekondare.Sistemi rrugor eshte parashikuar më një aks gjatësor që ndahet ne akse të tjera të tërthorta drjet objekteve te rendesishme ne zone.

Rruga kryesore eshte konceptuar pedonale, fillon tek rruga e Dibres dhe perfundon ne perdonalen e argjinatures. Kryqezimet jane te rakorduar ne forme rrethore.

Bimësia dekorative vendoset gjeometrikisht, nga të dyja anët e rrugëve. Kështu në një rrugë të drejtë drurët dekorativë vendosen në vijë të drejtë gjatë anëve të rrugës, 5-10 metra larg njëri tjetrit në varësi të llojit të drurit dekorativ .

Pedonalja e re , rruga kryesore jane parashikuar me gjeresi 5 m, rruget dytesore me gjeresi 3. m dhe rruicat e pista e vrapit me gjeresi deri ne 1.5 m.

Profili gjatësor i këtyre rrugëve ndjek konfiguracionin e terrenit Niveli i rrugëve eshte parashikuar te jete rreth 2 cm me poshte nga niveli i sipërfaqes së gjelbëruar, kurse bordure ne nje nivel me sipërfaqet e gjelberuara.

Cdo rrugë përfundon me ndonjë element përbërës të parkut .

Elementë arkitektoniko-dekorative jane parashikuar hyrja,shkallet lidhese, rrethimet, urat, çezma .

Hyrja- si element arkitektonik e rëndësishëm ne sipërfaqet e gjelbra eshte sipas stilit gjeometrik. Është vendi i hyrjes për në park, dhe pjesa që shërben si lidhje midis ambientit të qytetit dhe sipërfaqes së gjelbër të parkut.

Rrethimi- është kufiri i sipërfaqes së gjelbër dhe eshte parashikuar me rrethim te gjelber,ne hyrje ka bordure decorative betoni dhe me bimësi dekorative që duhet të mbahet e shkurtër.

Ura dekorative- jane parashikuar ndertim te urave ne vendet e kalimit te kanaleve te betonuara te perrenjve, Jane projektuar me konstruksion metalik .

Shkallët- janë në forma të rregullta dhe lidhijn parkun me pedonalen tek argjinatura. Shkallët do të ndërtohen prej betony pasi kane lartesi te konsiderueshme dhe ne te ardhmen mund te vishen me material te tjera ne pershtatje me parku., si pllaka guri, etj.

Çezma - elementë arkitektonikë më të përdorshëm në sipërfaqet e gjelbra. Do të ndërtohet prej betoni betoni me kater rubineta. Ajo eshte dekorative dhe shërben vetëm për të pirë ujë , eshte e pozicionuar ne hyrje te parkut.

Ndriçimi dekorativ i sipërfaqeve të gjelbra

Ndriçimi do te jete dekorativ ,lartësia e ndriçuesve korativ (0.5-4-6 metra nga toka), është e ndryshme në varësi të llojit, karakterit e madhësisë së objektit që do të ndriçohet.

Ne kete faze eshte parashikuar vetem shtrimi enntoke I tubit te ndricimit.

Bimësia dekorative dhe kompozimi e saj në sipërfaqet e gjelbra

Në sipërfaqet e gjelbra elementi bazë dhe faktori kryesor që përcakton kompozimin e tyre estetik mbetet gjithmonë bimësia dekorative.

Bimësia dekorative mund të lihet me rritje natyrore ose mund ti jepet edhe forma të rregullta sferike dhe gjeometrike, paralelepipedë, konike, etj.

Vecori të drureve dekorative, dallojmë:

drurë me kurorë ovale: panja, mështekna, ahu, gështenja, sofrë, blini, lisi,

drurë me kurorë të rrumbullakët; krerëza, panja, gështenja e kalit, katala, plepi, shëlg etj

drurët me kurorë konike; likuidampri, manjola, rrapi, kavuku, ilcia, bliri, akacia etj

drurë me kurorë si kolonë; mështekna, ahu, veriu etj

drurë me kurorë sferike; panja e malit, frashëri, akacia etj

drurë me kurorë të shtrirë si çadër, julibrisimi, plepi i bardhë cedrus, pishat, etj

drurë me kurorë konike; gjethëbredhat, selvia, varshi, hamecuparisi, gjinko, kryptomeria, pisha sekuoja, tisi, selvi e kënetave etj

drurë me kurorë vajtuëse; shëlg vajtuës, sofrë, dëllinja, tisi, ahu frashëri etj

Megjithëse drurët në përgjithësi i kanë gjethet në ngjyrë jeshile kjo nuk është e njëllloj të për të gjitha llojet e drurëve, por ndryshon në nuancën e saj. Pra sipas ngjyrës së gjethëve dallojmë:

Drurë me gjethë jeshile të errëta, që në vjeshtë kalojnë në të verdha. Gështenja e kalit, lisi i

kuq, blinj të panja e malit, plepi i kanadës etj. Drurë me gjethë jeshile të qelta, që në vjeshtë kalojnë në të verdhë të çelët; mështekna, bliri, akacia, sofrë, panja negundo, rrapi etj.

Drurë me gjethë bojçeqielli në jeshile që në vjeshtë kalojnë në ngjyra të verdhë si të kuqe; ahu, panja, etj.

Drurë me gjethë të verdha e jeshile të cilat në vjeshtë kalojnë në okër; mështekna, arra gështenja e butë etj.

Veçori të shkurreve dekorative

Sikurse edhe drurët, shkurret sipas veçorisë që kanë ndahen në disa kategori:

Sipas lartësisë ndahen në:

shkurre të larta- mbi 3 metra

shkurre mesatare-1-3 metra

shkurre të ultë- deri 1 metër

Sipas formës së kurorës ndahen në:

shkurre me kurorë ovale: shtogu i zi, jargavani, oleandri etj

shkurre me kurorë konike; shtogu e bardhë, manjola, biota, dëllinja, tisi etj

shkurre me kurorë si çadër; dëllinja, etj

shkurre me kurorë të hapur që është edhe pjesa më e madhe e tyre

shkurre me kurorë zvarranike; kotoneastri, hurdhia, lulesahati, hardhita e mureve poligonumi, etj

Sipas çështjes dhe rëndësisë së gjethëve

Kompozimi i bimësisë dekorative në sipërfaqet e gjelbra

1- Kompozimi i drurëve dekorativë

drurët dekorativë kompozohen me vendosjen në radhë duke formuar mure të gjelbra të krasitura në forma të ndryshme gjeometrike.

Si lloje më karakteristike për shkurret e veçuara mund të përmendim llojet: Abelia, melqinja, budlea, kotoneasteni, kali cotome, oleandri, manjola, fursithia, hibiskusi, jasemini, kerria, peonia, kumbulla e kuqe, shega, rododendroni, filadelfusi, trëndafilat e të gjitha llojeve, jargavani, butina, vaigalia, marina etj

Rregullimi i Kopshteve 63

Sipërfaqet e barit kanë gjithashtu një rëndësi të madh për mbrojtjen e sipërfaqe së tokës, prej shpëlarjes dhe gërryerjes të shkaktuara nga agjentët atmosferikë.

Sipërfaqet e përhershme bëjnë pjesë: me karakter dekorativ; për terrenet sportive; bar buzë rrugës; bari në skarpate

Sipërfaqe bari me karakter dekorativ

Ndertothen prane elementeve arkitekture .Kur toka paraqitet e varfër me lëndë organike, mbi të duhet hedhur deri 30 cm tokë e mirë vegjetale e përzier me pleh të kalbur organik.

Sipërfaqe bari të zakonshme. Këto përbëjnë pjesën më të madhe të sipërfaqeve të gjelbra. Në këto sipërfaqe do të mbillen drurët,shkurret dhe lulet me të cilat do të formohet vëllimi i parqeve e lulishteve.

Lëndina bari te lulezuara krijohen zakonisht në pjesët e parqeve që frekuentohen më shumë si psh: afër këndeve e shesheve për fëmijë, në afërsi të shëtitoreve ose atje ku njerëzit çlodhen për një kohë relativisht më të gjatë.

Lëndinat e lulëzuara krijohen edhe me lulet e zakonshme të lëndinave natyrore. Në këtë rast fara e barit përzihet me farën e luleve të lëndinave e kështu e përzieri mbillet. Në këto lëndina nuk praktikohet kositja.

Sipërfaqe bari në terrene sportive.

Duke qenë se këto janë sipërfaqe mbi të cilat zhvillohen lojëra të ndryshme; fara e barit duhet të ketë cilësi që:

- a) të mos mbajë ujën e shiut. Kjo sigurohet nëpërmjet përmirësimit të tokës dhe drenazhimit të saj
- b) të jetë fortë që të mos deformohet gjatë lojërave
- c) të ripërtërihet shpejt pas kositjes

Parqet publike.

Drurët që gjelbërojnë rrugët do të mbillen në të dy anet , në pjesën e gjelberuar me 0.7 m largësi nga buza e rrugës, në gropa me përmasa 80x80x80 cm ose 1x1x1.

Bimësia dekorative gjatë rrugëve do të mbillet në këto largësi, larg rrjetës së ndërtimit të nëndheshme:

-Nga tubat e ujës/jellësit kanalizimit dhe rrjetës elektrotelefonik, drurët duhet të jenë 2 metra larg, ndërsa shkurret 0.7 metër.

-Nga shtyllat e ndriçimit rrugor duhet të kenë jo më pak se 3 metra largësi, për shkurret kjo është e parëndësishme.

Parapërgatitja e terrenit për punimet e gjelbërimit.

Fillimisht do të kryhet pastrimi i territorit dhe përmirësimi i përbërjes së tokës.

Me pastrim të territorit, kuptojmë pastrimin e tokës nga të gjitha mbeturinat e ndërtimit (tulla,llaç, gurë, dërrasa, zhavorr etj).Kështu meqenese ndërtimi do të kryhet në një vend ku më parë ka patur mbeturina materiale ndërtimi, është mirë që para plehërimit në gjithë territorin të hidhet 25 – 30 cm trashësi dhe i mirë vegjetal, ndërsa gropa ku do të mbillet bimë si dekorative duhet të jetë e madhe dhe e mbushur edhe kjo me pleh të mirë.

Ndërtimi i sistemit rrugor.

Qëllimi i rrjetit rrugor në sipërfaqet e gjelbra është që të orientojë dhe lehtësojë lëvizjen e njerëzve dhe të transportit. Shtresat rrugore duhet të plotësojnë keto kushte: .

të ketë shtresë të rëluar mirë

të jetë e papërshkueshme nga uji

të jetë ekonomike, e kanalizuar mirë dhe estetike

Shtresa e cakullit hidhet në shtresën e rrugës në trashësi 10-15 cm trashësi. Kur trashësia e shtresës rrugore në gjendje të rëluar është 15 cm, cakulli ngjishet dhe rulohet, ndërsa kur ajo është mbi 15 cm ,

cakulli hidhet në dy duar. Rulimi në fillim bëhet në tokë të thatë, kurse më vonë duhet të bëhet duke e vaditur shtresën e rular me ujë (26-40 litra/cm³). Rulimi fillon nga anët e rrugës e pastaj në mes të saj. Gurët e cakullit mund të jenë 3-7 cm të mëdhenj, vetëm se ata nuk duhet të jenë të rrumbullakët por prej guri të thyer.

Profili tërthor i rrugëve në këtë shtresë bëhet me pjerrësi 3-4% ndërsa ai gjatësor 1-7 %. Rrugët me këtë lloj shtrese janë nga më të përdorshmet në sipërfaqet e gjelbra; anash do të kufizohen nga bordure . Bordurat janë prej betoni me përmasa jo më tepër se 8x20 x100 cm.

Teknikat e mbjelljes së drurëve, shkurreve, luleve e barit dekorativ

Koha e përshtatshme për mbjellje.

Drurët dhe shkurret zakonisht mbillen vetëm gjatë periudhës që janë në qetësi, pikërisht atëherë kur proceset jetësore të tyre zvogëlohen në minimum. Për drurët fletorë kjo periudhë fillon në vjeshtë me rënien e gjetheve (zakonisht në gjysmën e dytë të muajit tetor dhe në nëntor) dhe vazhdon deri në pranverë kur fillojnë të dalin sythët (në mars). Nuk lejohet në asnjë mënyrë që të bëhen mbjellje kur ka ngrica të forta. Si periudhë më e përshtatshme për mbjelljen e drurëve halorë rekomandohet koha kur tek ata ka mbaruar rritja e filizave, që fillon nga mesi i muajit gusht deri në fund të shtatorit, ndërsa në rajonet e ngrohta mund të vazhdojë deri në mes të tetorit. Në rast se mbjellja e tyre do të kryhet më vonë atëherë, ata nuk do të mund të rrenjëzohet lehtë dhe si rezultat mund të dështojnë.

Transportimi, stratifikimi dhe përgatitja e drurëve e shkurreve dekorative për mbjellje

Gjatë transportimit të fidanëve të drurëve e shkurreve dekorative nga fidanishtja deri në objektin ku do të mbillen, është e rëndësishme që ato të mbrohen për të mos u tharë sistemi rrënjor e veçanërisht qimet thithëse të tyre. Për këtë, menjëherë mbas shkuljes, drurët, shkurret, duhet të zbuten duke i futur në një përzierje argjile me ujë.

Kur fidanët transportohen në largësi të mëdha, ato duhet të ambalazhohen mire me bar të lagur, rrogozë, myshqe, tallash druje të trashë etj. Kur trupi i fidanëve mbështetet në material të fortë (si në sfondin anësor ose të mbrapmë të karrocërisë së kamionit) duhet të mbështillen me materiale të buta me qëllim që të mbrohen nga plagosja ose zhveshja e pjesshme e lëkurës së trupit.

Gjatë transportimit të tyre nuk duhet lejuar ulja mbi fidanë ose vendosja e çfarëdo peshe mbi to.

Gjatë ngarkimit dhe shkarkimit të fidanëve duhet gjithashtu të tregohet kujdes i veçantë që ato të mos dëmtohen. Në përgjithësi fidanët në fidanishte shkulen me bukë dheu (me dhe rreth rrënjëve). Ky është kushti I domosdoshëm sidomos për drurët dhe shkurret halore si: bredhi, cedrus, pishë selvi etj. dhe ata fletorë gjethembajtës si: ligustër, mimoze ilqe dafinë etj. pavarësisht në se ata do të transportohen në largësi të afërta apo të largëta. Prej saj varet shumë përqindja e zënies së tyre mbas mbjelljes.

Në rast se fidanët e shkulura nuk transportohen e mbillen brenda ditës, atëherë ata duhet të stratifikohen duke i vendosur në një vend me hije dhe duke i mbuluar me material të lagur ambalazhi ose me dhe.

Kanali në të cilin stratifikohen fidanët bëhet i thellë dhe i gjerë 40/50/60 cm, në varësi të madhësisë së sistemit rrënjor të fidanëve, dhe i pjerrët me kënd rreth 45°. Në kanale fidanët e drurëve, vendosen një nga një, ndërsa shkurret vendosen në grupe. Këtu rrënjët e tyre duhet të mbulohen me dhe të ngjeshur mire me qëllim që të mos krijohen boshllëqe midis rrënjëve të fidanëve; në rast të kundërt ajrosja e rrënjëve mund të shkaktojë edhe tharjen e tyre. Kjo është e domosdoshme sidomos kur fidanët do të rrinë pa u mbjellë nga vjeshta deri pranverën e vitit të ardhshëm.

Në rastet kur mbas stratifikimit koha vazhdon të jetë e thatë, është e nevojshme vadija e tokës ku janë vendosur. Kur fidanët që do të stratifikohen janë të llojeve të ndryshme, është mirë që secili prej tyre të vendoset në kanal in e tij të veçantë, ose mund të vendosen në një kanal të përbashkët, port ë ndarë simbas llojeve.

Kujdesi gjatë mbjelljes së fidanëve. Para mbjelljes, çdo fidan duhet të shikohet me kujdesin më të madh. Rrënjët e gjata dhe ato të kalburat duhet të priten me gërsërë ose sharrë krasitëse. Gjithashtu priten të gjitha rrënjët të cilat nuk kanë prerje të rrafshët e të lëmuar. Me qëllim që thithja dhe avullimi të ekuilibrohet, duhet të bëhet edhe prerja e të gjitha degëve të thata e të dëmtuara dhe e një pjese të mirë të degëve të shëndosha.

Përgatitja e tokës dhe hapja e gropave për mbjellje. Për rritjen normale të fidanëve një rol të madh luan punimi i mirë i thellë I tokës. Gjate ndërtimit të sipërfaqeve të gjelbra ndodh shpesh që duhen mbjellë edhe ato territore ku toka paraqitet e varfër ose me përbërje të keqe. Në këto raste është e nevojshme që duke u mbështetur në projektin e planifikimit vertikal; të hiqet shtresa e sipërme e tokës prej 30-40 cm, trashësi, dhe kjo të zëvendësohet me tokë të mirë vegjitale.

Mbasi ka përfunduar punimi i përgjithshëm I tokës, caktohen vendet se ku do të mbillen drurët dhe shkurret dekorative. Ky vend caktohet duke vendosur në tokë piketa të etiketuar simbas llojeve të fidanëve. Madhësia e gropave është e ndryshme për drurët dhe për shkurret. Ajo varet prej përbërjes së tokës, moshës së fidanit dhe madhësisë e shtrirjes së vetë sistemit rrënjor të tyre. Dy-tre vjet mbas mbjelljes, fidanët kërkojnë tokë më të shkrifët dhe më pjellore me qëllim që të zhvillojnë më mirë sistemin e tyre rrënjor. Prandaj madhësia e gropes duhet të jetë e tillë që jo vetëm rrënjët e fidanit të futen pa u shtrembëruar e lehtësisht në gropë, por të ketë edhe 15-20 cm, largësi nga anët.

Për drurët dekorativë me moshë nga 6-8-10 vjeç zakonisht gropa ka përmasat 80x80x80 cm. Në rast se toka është me përbërje ranore, argjilore e rëndë ose e varfër, gropat happen me përmasa edhe më të mëdha 1x1x1 m, 1.20x1.20x1.20 m, ose 1x1x1.5 m.

Për mbjelljen e shkurreve, madhësia e gropave bëhet gjithmonë më e vogël se sa për drurët. Kështu për shkurret e larta gropa hapen me përmasa 70x70x70 cm, ose 60x60x60 cm ndërsa për shkurret e ultë me përmasa 50x50x50 cm, ose 40x40x40 cm.

Forma e gropës zakonisht bëhet e rrumbullakët dhe me anë të pjerrëta, në formën e një koni të prerë, por në praktikën e ndërtimit të gjelbër përdoret edhe forma katrore e gropave. Në asnjë rast gropat nuk duhen të hapen në formë katërkëndëshi sepse kjo shkakton zhvillimin jot të barabartë të sistemit rrënjor të drurëve e shkurreve dekorative.

Gjatë hapjes se gropave duhet patur parasysh që shtresa e sipërme e tokës (në thellësi 20-50 cm) është më pjellore dhe me strukturë fizike më të mirë se sa shtresa e poshtme. Prandaj kur çelet gropa shtresa e sipërme e tokës hidhet në njërën anë të saj (në të djathtë) ndërsa shtresa e poshtme në anën tjetër (në të majtë). Kështu gjatë mbjelljes, shtresën e tokës që kemi hedhur në të djathtë ia hedhim fidanit në fund ndërsa shtresën tjetër sipër.

Teknika e mbjelljes se drurëve e shkurreve.

Përpara se të mbillet fidani, në gropën e hapur vendoset huri i drunjtë me diametër 4-6 cm, i cili do të shërbejë për mbajtjen e drejtë të fidanit. Huri duhet të jetë i zhveshur nga lëkura dhe i lyer me zift me qëllim që të mos kalbet shpejt dhe të mos bëhet çerdhe mikrobesh të dëmshme. Gjatësia e hurit duhet të jetë aq sa, mbasi të jetë vendosur në gropë dhe fidani të jetë mbjellë, maja e hurit të arrijë deri atje ku filon kurora e fidanit. Mbasi huri vendoset në gropë, rreth e qark tij dhe në fund të gropës hidhen 2-3 lopata dhe i mirë e pleh stalle i dekompozuar. Mbas kësaj në qendër të gropës vendoset fidani perpendikularisht dhe përsëri rreth e qark rrënjëve të tij hidhet dhe i mirë e pleh, i cili ngjeshët vazhdimisht me këmbë duke filluar nga periferia në qendër të gropës. Gjatë mbjelljes së fidanit duhet pasur kujdes që rrënjët të mos përdridhen sepse ndodh që edhe mbas 10-15 vjetëve mund të shkaktohet kalbëzimi I tyre dhe tharja e vetë fidanit.

Mbjellja e fidanit duhet të bëhet prej dy punëtorëve. Kështu ndërsa njëri prej tyre mban fidanin drejt dhe e lëviz atë vazhdimisht me qëllim që dheu të futet nëpër rrënjët dhe të mos krijohen boshllëqe, tjetri hedh dheun në mënyrë të barabartë nga të gjitha anët e gropës duke e ngjeshur atë vazhdimisht me këmbë.

Në gropën ku është mbjellë fidani, dheu duhet të qëndrojë 3-5 cm, më lart se sa niveli i territorit, me qëllim që mbas cedimit të tij të fitohet niveli i mëparshëm. Këshillohet që mbas mbjelljes së fidanit, rreth e për qark gropës të bëhet një unazë prej dheu 15-20 cm, nga niveli i territorit me qëllim që gjatë vaditjes ose reshjeve ajo të shërbejë si rezervuar për grumbullimin e ujit.

Mbas mbjelljes, fidani duhet të vaditet vazhdimisht qoftë edhe në kohë me shi mbasi ujët ndihmon cedin dhe ngjeshjen e dheut si dhe ngjitjen e tij më mirë në rrënjët e fidanit. Për vaditjen e çdo druri të mbjellë nevojiten 20-25 litra ujë, kurse për çdo shkurre 12-15 litra.

Fidani duhet të lidhet mbas hurit me lidhëse vetëm në një vend dhe sit ë kenë kaluar 2-3 javë, toka të ketë ceduar mirë, fidani duhet të lidhet në dy vende: njëherë në 40-50cm, lart nga toka dhe njëherë pak më poshtë ë 10-15 cm, nën kurorën e tij.

Lidhja e fidanit mbas hurit bëhet në formën e numrit 8. Kjo mënyrë lidhjeje mënjanon fërkimin fidanit me hurin në kohë me erë. Kur fidanët mbillen në trotuare ose gjatë rrugëve të qendrave të vogla të banuara, ku mund të pësojnë dëmtime mekanike prej automjeteve ose kafshëve, është e nevojshme që ato të rrethohen me thurëse të përshtatshme metalike ose prej druri. Kur drurët mbillen në grupe ose masiv për mbajtjen e ujit gjatë vaditjes ose reshjeve, bëhet një unazë prej dheu e përbashkët për gjithë drurët e grupit apo masivit. Teknika e mbjelljes së shkurreve është e njëjlojtë me atë të drurëve që përshkruam më lart.

Teknika e mbjelljes së drurëve të rritur.

Në ndërtimin e sipërfaqeve të gjelbra, për të fituar një efekt të shpejtë dhe të parakohshëm, përdoret edhe mbjellja e drurëve të rritur.

Kjo teknik ka filluar të përdoret gjerësisht edhe në vendin tonë. Më shumë përdorim ka gjetur në gjelbërimin e trotuareve të rrugëve të reja dhe të atyre të vjetra ku në radhën e drurëve ekzistues, duhen zëvendësuar drurë të veçantë, të cilët vjetrohen, dëmtohen, deformohen ose rrëzohen nga era dhe kështu prishin njëlojshmërinë e gjelbërimit të rrugëve e bulevardeve. Shkulja dhe mbjellja e drurëve të rritur në praktikën e ndërtimit të gjelbër bëhet më me vështirësi se sa për fidanët e vogla.

a. Shkulja e drurëve të rritur. Para fillimit të shkuljes, duhet të caktohet se sa do të jetë diametri i bukës së dheut. Ky praktikisht përcaktohet duke marrë 8-10 herë diametrin e trungut të fidanit në lartësi nga toka 1.30m. Po kështu thellësia e bukës së dheut përcaktohet nga madhësia dhe shtrirja e sistemit rrënjor të fidanit. Në përgjithësi kjo thellësi është rreth 80-100 cm. Forma e bukës së dheut duhet të jetë kubike, iramidë e prerë me bazë katrore ose cilindrike. Në qendër duhet të jetë trungu I pemës. Gjatë shkuljes së fidanëve të rritur duhet të ruhet dhe të mos dëmtohet sistemi rrënjor bazë (kryesor), por të priten vetëm rrënjë të veçanta të trasha, të thyera gjatë prerjes ose të kalbura. Prerja e këtyre rrënjëve duhet të bëhet e rrafshët dhe përpjendikulare për të mos shkaktuar çarje të rrënjëve, sepse kjo mund të sjellë kalbëzimin e tyre dhe mbas një kohe edhe tharjen e vetë fidanit. Mbase të jetë caktuar madhësia dhe forma e bukës së dheut, rreth e qark fidanit hapet transhe me gjerësi 30-35 cm, dhe thellësi 10-15 cm, më tepër se thellësia e caktuar për bukën e dheut, sepse kështu punëtori punon lehtësisht për prerjen e rrënjëve. Hapja e transhesë zakonisht bëhet me bel, sëpata në gjendjen të mirë pune dhe me bishta të shkurtër me qëllim që punëtori të manovrojë lehtësisht.

Në rastin e ambalazhimit prej dërrase veprohet kështu: dërrasat me gjatësi sa madhësia e bukës së dheut dhe me trashësi 5cm, mbërthehen paraprakisht jashtë gropës, veças, për çdo faqe të formës së bukës së dheut. Pastaj këto montohen në vend duke mbërthyer në pjesën e sipërme dërrasa më të trasha në formë kryqi 10-15 cm, larg trungut të fidanit me qëllim që gjatë transportit të mënjanohet zhveshja e lëkurës së trungut të tij. Mbas kësaj arka e formuar përcaktohet duke mbërthyer edhe nga poshtë me dërrasa të të njëjtës përmasë. Kjo kryhet më me lehtësi kur fidanin me gjithë arkë e kthejmë pjerrtësi. Pasi të ketë përfunduar inkasimi I bukës së dheut, fidani është gati për transportim në vendin e ri. Kur inkasimi bëhet me kashuna metalikë, ata parapërgatiten në dy pjesë, të cilat duke u bashkuar, formojnë një trung koni. Mbase fidani të jetë shkukur, bukës së dheut i jepet forma e kashunit metalik dhe madhësia pak më e vogël se vetë kashuni me qëllim që ai të mbyllet plotësisht. Dy pjesët e kashunit shtrëngohen mirë derisa të bashkohen kllapat metalike dhe pastaj lidhen me tel ose bulona. Në këtë gjendje fidani është gati për t'u transportuar. Drurëve të rritur, një vit më parë, duhet t'u bëhet prerja e sistemit rrënjor duke pasë parasysh Rregullimi i Kopshteve 104 madhësinë e bukës së dheut me të cilën do të shkulen.

b) transportimi i drurëve të rritur. Drurët e rritur të inkasuar, detyrimisht duhet të transportohen me automjet. Duke qenë se pasha e bukës së dheut dhe e fidanit është shumë e madhe ngarkimi i fidanit në automjet bëhet me vinç. Me qëllim të gjatë transportit, të mos dëmtohen degët e fidanit, ato duhet të lidhen me litar në formë spirale.

Në automjet, fidani vendoset i shtrirë në mënyrë të tillë që kashuni me bukën e dheut të arrijë deri në kabinën e shoferit. Në pjesën e karrocërisë së automjetit ku mbështeten degët e fidanit, duhet të vendosen material të buta ambalazhimi, sikurse edhe gjatë transportimit të fidanëve të vegjël, me qëllim që të mos shkaktohen dëmtime. Që fidani gjatë ngarkimit e shkarkimit të rrotullohet në çdo pozicion, ai duhet të lidhet me litar të gjatë dhe të ngrihet me vinç.

Mbas ngarkimit të fidanit, bashkë me automjetin nisët për në vendin e mbjelljes edhe vinçi. Kur fidani transportohet në largësi të largëta e në kohë me diell, pjesa e inkasuar e bukës së dheut duhet mbuluar me

rrogozë, të cilët duhet të mbahen të lagura gjatë gjithë kohës së transportimit. Nuk këshillohet asnjëherë që fidanë të tilla të shkulet, transportohen e mbillen kur temperatura zbret në (-10 grade).

Për mbjelljen e drurëve të rritur, është kusht i domosdoshëm, që fidanit para se të shkulet e të transportohet, duhet t'i shënohet në trung me bojë vaji drejtimi veri-jug që ka pasë në vendin ekzistues, sepse edhe në vendin e ri të mbledhjes fidani duhet të vendoset po në atë drejtim. Mosrespektimi i kësaj shpesh shkakton zhvillim jonormal të kurorës së fidanit.

c) Mbjellja e drurëve të rritur. Gropa në të cilën mbillen drurët e rritur, duhet të hapet disa ditë më përpara se të kryhet mbjellja.

Fidanit, mbasi vendoset perpendikularisht në gropë (mbi 30-40 cm, tokë pjellore që është hedhur paraprakisht), i hiqet inkasimi dhe pastaj pjesa bosh mbushet vazhdimisht me dhe të mirë vegjetal, i cili duhet të vaditet me ujë të bollshëm.

Kur gropa është mbushur plotësisht me dhe, rreth e përqark saj formohet një unazë dheu e cila do të shërbejë më vonë për mbajtjen e ujit gjatë vaditjes dhe reshjeve. Këtë ujë fidani do ta thithë gradualisht për një kohë më të gjatë. Me këtë përfundon mbjellja e fidanit të rritur. Për ta ruajtur nga përkulja dhe shtrembërimet që mund të shkaktohen nga era, fidani, atje ku fillon kurora lidhet nga të tëra anët me tel i cili fiksohet në kunjat e futur në tokë. Trupi i fidanit në vendin ku lidhet me tel duhet të mbështillet me material të buta ambalazhimi. Kjo lidhje i hiqet fidanit vetëm mbas 2-3 vjetëve.

Vitin e parë mbas mbjelljes, këto drurë duhet të vaditen rregullisht. Toka poshtë kurorës duhet të shkrihet dhe prashitet, kurse gjatë verës kur temperatura është e lartë është e nevojshme që t'u bëhet edhe vaditja e spërkatja me ujë e kurorës.

Krijimi i sipërfaqeve të barit dekorativ.

Për të përcaktuar sasinë e farës së nevojshme të barit që do të mbjellim duhet pasur parasysh lloji i sipërfaqes së gjelbër, madhësia e kokrave të farës së barit dhe kushtet tokësore e klimaterike të objektit. Bari rritet mirë atëherë kur mbillet në atë mënyrë që çdo fare t'i takojë rreth 2 cm², sipërfaqe toke pjellore (kryesisht për farërat e mëdha) dhe rreth 1 cm² sipërfaqe për farërat me madhësi më të vogël. Kur fara e barit mbillet dendur, jep efekt më të mirë dekorativ dhe nuk lejon rritjen e barërave të këqija, veçse në këtë rast ajo ka jetë më të shkurtër. Kur fara e barit mbillet rrallë, atëherë ajo ka jetë më të gjatë, është durueshme karshi thatësisë, zhvillon sistem rrënjorë më të mirë, por nuk jep efekt të mirë dekorativ.

Në rast se fara e barit ka deri 70% fuqi mbirëse atëherë për të krijuar një sipërfaqe bari të zakonshme në 1000 m² sipërfaqe toke mund të mbillet 20-25 kg farë bari. e madhësisë së *Lolium perenne*, ndërsa për të krijuar parterë bari dekorativ në 1000 m² sipërfaqe, duhet të mbillet 25-30 kg farë bari. Farë bari me 100% fuqi mbirëse zakonisht në praktikën e gjelbërimit nuk përdoret. Përcaktimi i sasisë së farës së barit që duhet mbjellë, bëhet gjithmonë duke u bazuar në fuqinë mbirëse të saj.

Përzierja e farës. Sipërfaqet e barit të krijuara vetëm nga një lloj bari, jetojnë më pak dhe kanë efekt më të vogël dekorativ. Kështu p.sh. një sipërfaqe bari e krijuar vetëm me *Lolium perenne* jeton 3-5 vjet, kurse tek ne është vërtetuar se sipërfaqet e barit të krijuara vetëm me *Lolium italicum* jetojnë 1 vit dhe rrallë dy vjet. Në rast se përdoret përzierje e farës së barit atëherë jeta e sipërfaqeve të tyre rritet në 8-10 vjet. Se si duhet përzierja, kjo varet nga qëllimi për të cilin krijohet sipërfaqja e barit, e prej mundësive të vaditjes, nga kushtet e tokës dhe të klimës së një rajoni të caktuar. Përzierja më e mirë krijohet me 4-5 lloje fare bari, por më tepër nuk lejohet për arsye sepse krijohen kushte jo të favorshme për zhvillim. Për kushtet tona mund të rekomandojmë këto përzierje farash bari dekorativ për lloje të ndryshme sipërfaqesh bari.

Për sipërfaqe të zakonshme bari

a) në tokat që rrihen nga dielli, pak a shumë të thata dhe jo shumë pjellore përdoren: *Agrostis vulgaris* - 70%, *Cinurus chrislatus* - 30%; ose *Festuca rubra* - 70%, *Poa pratensis* - 20%, *Lolium perenne* - 10%

b) për toka pjellore në gjysmëhije: *Poa pratensis* - 70%, *Festuca rubra* - 30%; ose *Poa pratensis* - 50%, *Poa nemoralis* - 30%, *Festuca rubra* - 20%.

Për terrene e sheshe sportive: *Lolium*

perenne - 50%, *Festuca rubra* - 30%, *Agrostis alba* - 20%. Për lëndina e livadhe: *Festuca rubra* - 30%, *Poa trivialis* - 30%, *Agrostis vulgaris* - 15%, *Lolium pa* - 20%, *Trifolium repens* - 5%.

Në vendet me shume hije, ku nuk zhvillohen barërat dekorative, veçanërisht poshtë masivëve të drurëve halorë, mund të mbillen Vurlh, Vinka, geraniuim dhe me barin që shtohet me ndarje, i cili është përdorur gjerësisht në disa parqe e lulishte të Tiranës.

Përgatitja e tokës për mbjelljen e farës së barit. Para se të fillohet nga mbjellja e farës, duhet që të kenë përfunduar të gjitha punimet si: kanalizimi, ujësjellësi, ndriçimi dekorativ etje. dhe të jetë mbjellë bimësia e lartë dekorative. Përgatitja e tokës për mbjelljen e farës në sipërfaqet e barit të përkohshëm nuk bëhet e njëjlojte si për sipërfaqet e barit të përhershëm.

Në të parat terreni pastrohet nga mbeturinat e ndërtimit; shpesh nivelohet, punohet deri në 20 cm, thellësi, plehërohet po qe se është e nevojshme dhe pastaj mbillet fara. Kurse për sipërfaqet e barit me karakter të përhershëm bëhet përgatitja e gjithanshme e tokës. Hiqen të gjitha mbeturinat e ndërtimit. e në rast se toka nuk është pjellore, atëherë deri në 20-25 cm, thellësi ajo hiqet,dhe në vendin e saj hidhet tokë pjellore e pasur me lënde organike dhe humus.

Për këtë më mirë është plehërimi me pleh stalle të dekompozuar mirë duke hedhur në çdo 1000 m² sipërfaqe 5-10 ton pleh ose praktikisht 10-20 karroca. Në mungesë të plehut organik mund të përdoren edhe plehurat minerale të përziera, kështu në 1000 m² sipërfaqe, zakonisht hidhen 15 kg,plehra azotike me veprim të shpejtë, 3-5 kg, superfosfate dhe 3-5 kg. kripëra potasi. Mbas plehërimit, toka nivelohet mirë dhe është gati për mbjelljen e farës.

Mbjellja e farës së barit dekorativ.

Mbjellja e farës së barit dekorativ është mirë të bëhet mbas 10-20 ditësh kur terreni të jetë punuar e niveluar mirë. Kjo jep mundësinë që toka të kullohet, të mbulohet të çarat e krijuara gjatë nivelimit dhe të zhduken barërat e këqija. Fara e barit mund të mbillet prej fillimit të pranverës e deri në fund të vjeshtës, mjafton që të sigurohet vaditje e vazhdueshme. Fara e barit e mbjellë në kushte normale mbin më mirë, rrënjëzohet më shpejt dhe u duron thatësirave të verës.

Mbjellja e farës së barit kryhet me dorë (sikurse shumë fara të tjera: gruri,jonxha, etj.) dhe hidhet në mënyre të tillë që të sigurohet një shpërndarje mundësisht e barabartë në të gjithë territorin. Kur fara përbëhet nga shumë lloje, ajo duhet të përzihet vazhdimisht, me qëllim që të mos bien farat e një lloji në të njëjtin vend.

Në afërsi të bordurave të rrugëve e parqeve, fara e barit hidhet më e dendur se sa në brendësi të parcelave, meqenëse gjatë vaditjes një pjesë e tyre shkon në brendësi të parcelave dhe kështu krijohet një qilim bari jo i njëjlojtë. Duhet patur parasysh që në ditë me erë nuk duhet të mbillet farë bari, mbasi era i shpërndan ato në mënyrë të pabarabartë. Farërat e mbjella të barit ngjishen duke I futur në toke 0,5-1 cm. Për sipërfaqe të vogla, futja e farës në tokë behet duke e shkrifëruar tokën me krehër, kurse për sipërfaqe të mëdha bëhet me rul special me gozhda që dalin jashtë rulit rreth 3-5 cm. dhe 2-3 cm, larg njëra tjetrës. Mbas mbjelljes së farës, fillon ngjeshja e tokës.

Për sipërfaqe të vogla ngjeshja mund të bëhet me ndihmën e dy dërrasave të lidhura në këmbët e lulishtarit. Dërrasat janë me përmasa 25x40 cm. dhe nga ana e poshtme e tyre duhet të jenë të lëmuara me qëllim që të mos ngjitet balta në to.

Për sipërfaqe të mëdha, ngjeshja bëhet me rul, njëra rrotë e të cilit (rrota me gozhda) shërben për futjen e farave në tokë, kurse tjetra (rrota e lëmuar) shërben për ngjeshjen e tokës. Ky rul peshon 50- 80 kg. dhe me të ngjishet gjithë sipërfaqja, kurse anët qe nuk i kap ruli ngjishen me dërrasa. Ngjeshja e fares bëhet me qëllim që të ruhet lagështira e tokës e cila ndihmon në mbirjen e shpejtë të farës.

Mbasi toka të jetë ngjeshur mirë fillon të vaditet zakonisht ajo bëhet çdo ditë. Kur koha është shumë e nxehtë, sidomos gjatë verës, ajo bëhet dy herë në ditë, një here në mëngjes (deri në ora 10) dhe një herë mbas dreke, (mbas orës 17). Para se të bëhet kositja e parë, është mirë që bari të ngjishet me rul të rëndë deri 80 kg. që të formohet plis me bar me të dendur.

Mbjellja e fidanëve është një tjetër process shumë delikat i cili nëse nuk kryhet mire sjell tharjen e bimës. Në disa bimë mbjellja kryhet në forma të ndryshme; me bimë të re, me fidanë, me copa, me përpaja etj. Mbjellja e bimëve barishtore bëhet duke hapur vija të cektë në largësinë 30-70 cm, ndërsa për fidanët 15-

40 cm. Mbjellja bëhet edhe duke hapur vrima me kunj në drejtim të rreshtit. Aty vendoset fidani e më pas bëhet ngjeshja e tokës dhe ujitja. Mbjellja e shkurreve dhe bimëve të larta bëhet duke hapur gropa me dimension 0.5x0.5x0.5 ose 1x1x1 gjithmonë në varësi të llojit që do mbillet. Mbjellja shoqërohet me plehërim të gropës dhe rrënjët e fidanit shpërndahen me kujdes në të gjithë hapësirën e gropës. Mbjellja kryhet në dimër duke shmangur ngricat.

Acer pseudoplatanus

Lartesia:	15.20m - 24.40m
Gjeresia:	10.60m - 15.20m
Rritja:	E shpejte
Ekspozimi:	Hije e plote, diell I plote
Gjethja:	Gjethegjere, gjetherenese
Ngjyra e lules:	Jeshile
Periudha e lulezimit:	Pranvere
Ngjyra e gjethes:	Jeshile
Ngjyra e frutit:	Kafe, jeshile
Kerkesa per uje:	Kerkon lageshtire
Kerkesa e pH:	Acidie, neutrale, alkaline, lehtesisht alkaline
Lloji i tokes:	Ranore, argjilore, lymore
Forma:	Rrumbullakosur, rritje horizontale e ne lartesi
Perdorimi:	Bime e vetme, barriere, autostrada dhe rruge
Lartesia:	15.20m - 24.40m



Acer saccharum

13.80m - 18.20m

Lartesia:

Gjeresia:

4.60m - 6.00m

Rritja:

I ngadalte

Ekspozimi:

Hije e pjesshme ose diell i pjesshem, diell i plote

Gjethet:

Gjethegjere, gjetherenese

Ngjyra e lules:

Jeshile

Periudha e lulezimit:

Pranvere

Ngjyra e gjethes:

Jeshile

Ngjyra e frutit:

Kafe

Kerkesa per uje:

Kerkon lageshtire

Kerkesa e pH:

Acide, neutrale, alkaline e lehte

Lloji i tokes:

Ranore, argjilore, lymore

Forma:

Ovale, e ngritur

Perdorimi:

Bime e vetme, per rruge dhe autostrada

Karakteristika:

Terheq zogjte



Aesculus hippocastanum

Lartesia:	5320 m – 22.80 m 10.60m - 15.20m
Gjeresia:	E ngadalte
Rritja:	Diell I plote
Ekspozimi:	Deciduous, broadleaf
Gjethet:	E bardhe
Ngjyra e lules:	Pranvere
Periudha e lulezimit:	Jeshile
Ngjyra e gjethes:	Kafe
Ngjyra e fruti:	Kerkon lageshtire
Kerkesat per uje:	Acid, neutral, alkaline
Kerkesat per pH:	Ranore, argjilore, lymore
Lloji i tokes:	Balkan Peninsula
Habitati:	Ovale, piramidale
Forma:	Peme rruges
Perdorimi:	




Albizia julibrissin

Lartësia:	4.60m deri në 7.60m
Gjerësia:	7.60m deri në 10.60m
Rritja:	E shpejtë
Ekspozimi:	Diell
Rezistenca e gjethes:	Gjetherënës, gjethegjërë
Ngjyra e lules:	Rozë
Sezoni i celjes:	Pranverë, verë
Atributet e lules:	Aromatike
Ngjyra e frutit:	Jeshile
Ngjyra e lules:	Kafe
Kërkesa për ujë:	Me lagështi
pH i tokës:	Acide, neutrale, pak alkaline
Lloji i tokës:	Ranore, argjilore, e shkrifët
Habitati i origjines:	Nga Irani në Japoni
Forma:	E përhapur ose horizontale, vazo
Atributet:	Tërheq zogjtë, ka gjete tërheqëse, invazive



Betula spp.

Lartësia:	7.60m ne 15.20m
Gjerësia:	4.60m ne 7.60m
Rritja:	E shpejte
Ekspozimi:	Hije e pjesshme për diell të plotë
Rezistenca e gjethes:	Gjetherënës, gjethegjërë
Ngjyra e lules:	Kafe
Sezoni i celjes:	Pranvere, Dimer
Atributet e lules:	Terheq flutura
Ngjyra e gjethes:	Jeshile
Ngjyra e frutit:	Kafe
Kërkesa për ujë:	Lageshti
pH i tokës:	Acide, neutrale, pak alkaline
Lloji i tokës:	Ranore, balte, e shkrifët
Vendi i origjines:	Amerika Veriore
Forma:	Ovale, piramidale, e ngritur ose e drejte
Atributet:	Terrheq zogjte



Fraxinus excelsior

Lartesia:	15.20m - 22.80m
Gjeresia:	12.20m - 16.80m
Rritja:	E shpejte
Ekspozimi:	Diell i plote
Gjethet:	Gjetherenese, Gjethegjere
Ngjyra e lules:	Jeshile
Periudha e lulezimit:	Pranvere
Ngjyra e gjethes:	Jeshile
Ngjyra e frutit:	Jeshile, e erret
Kerkesa per uje:	Lageshtire
Kerkesa e pH:	Acide, neutrale, alkaline, alkaline e lehte
Lloji i tokes:	Ranore, argjilore, lymore
Habitati:	Europe, Azia e Vogel
Forma:	Rrumbullaket
Perdorimi:	Bime e vetme, per rruge dhe autostrada



Liquidambar styraciflua "Worplesdon"

Lartesia:	15.20m - 22.80m
Gjeresia:	10.60m - 15.20m
Rritja:	Mesatare
Ekspozimi:	Hije e pjesshme ose diell i pjesshem, diell i plote
Gjethet:	Gjetherenese, Gjethegjere
Ngjyra e lules:	Jeshile, e verdhe
Periudha e lulezimit:	Pranvere
Ngjyra e gjethes:	Jeshile, e larmishme, e verdhe
Ngjyra e frutit:	Kafe
Kerkesa per uje:	Kerkon lageshtire
Kerkesa e pH:	Acide, neutrale, alkaline e lehte
Lloji i tokes:	Ranore, argjilore, lymore
Forma:	Ovale, piramidale
Perdorimi:	Bime e vetme, per rruge dhe autostrada



Liriodendron tulipifera

Lartesia:	19.80m - 27.40m
Gjeresia:	13.80m - 18.20m
Rritja:	Mesatare
Ekspozimi:	Diell i plote
Gjethet:	Gjetherenese, Gjethegjere
Ngjyra e lules:	Jeshile, e verdhe
Periudha e lulezimit:	Pranvere
Krakteristikat e lules:	Terheqese per flutura, lule aromatike
Ngjyra e gjethes:	Jeshile
Ngjyra e frutit:	Kafe
Kerkesa per uje:	Kerkon lageshtire
Kerkesa e pH:	Acide, neutrale
Lloji i tokes:	Ranore, argjilore, lymore
Forma:	Ovale, e rrumbullaket
Perdorimi:	Bime e vetme, per rruge dhe autostrada



Platanus orientalis

Lartesia:	21.40m - 27.40m
Gjeresia:	21.40m - 24.40m
Rritja:	E shpejte
Ekspozimi:	Hije e pjesshme ose diell i pjesshem, diell i plot
Gjethet:	Gjetherenese, Gjethegjere
Ngjyra e lules:	n/a
Periudha e lulezimit:	Pranvere
Ngjyra e gjethes:	Jeshile
Ngjyra e frutit:	Kafe e erret
Kerkesa per uje:	Kerkon lageshtire
Kerkesa e pH:	Acide, neutrale, alkaline, alkaline e lehte
Lloji i tokes:	Ranore, argjilore, lymore
Forma:	Piramidale, e rrumbullaket
Perdorimi:	Bime e vetme, per rruge dhe autostrada



Robinia pseudoacacia

Larësia:	15.20m deri 22.80m
Gjerësia:	9.20m deri 13.80m
Rritja:	E shpejtë
Ekspozimi:	Pjesërisht hije ose pjesërisht diell deri në diell të plotë
Rezistenca e gjethes:	Gjetherënës, gjethegjerë
Ngjyra e lules:	E bardhë
Sezoni i celjes:	Pranverë
Atributi i gjethes:	Tërheq flutura, lule aromatike
Ngjyra e gjethes:	E gjelbër, blu
Ngjyra e frutit:	I zi, i kuq
Kërkesa për ujë:	I thatë deri në të lagësht
pH i tokës:	Acide, neutrale, alkaline
Lloji i tokës:	Ranore, balte, e shkrifët
Habitati i origjinës:	Rritet më mirë në tokat e pasura gëlqerore me lagështi, por mund të gjendet kudo ku toka drenazhohet mirë në rajonin Appalachian dhe lindor të Amerikës Veriore. Është e zakonshme në shpatet lindore nën 3400 këmbë lartësi.
Forma:	Ovale, e drejtë ose e ngritur
Përdorimi:	Kontroll erozioni
Atributet:	Invazive, natyralizuese



Tilia platyphyllos

Lartesia:	18.20m - 26.00m
Gjeresia:	13.80m - 19.80m
Rritja:	E shpejte
Ekspozimi:	Hije e pjesshme ose diell i pjesshem,diell i plote
Gjethet:	Gjetherenese, Gjethegjere
Ngjyra e lules:	E verdhe
Periudha e lulezimit:	Vere
Karakteristikat e lules:	Lule aromatike
Ngjyra e gjethes:	Jeshile
Ngjyra e frutit:	Kafe e erret
Kerkesa per uje:	Kerkon lageshtire
Kerkesa e pH:	Acide, neutrale, alkaline, alkaline e thjeshte
Lloji i tokes:	Ranore, argjilore, lymore
Forma:	Ovale, piramidale
Perdorimi:	Bime e vetme, per rruge dhe autostrada



MBI REHABILITIMIN E ISH-VENDDEPOZITIMIT TE MBETJEVE URBANE

Vend depozitimi eshte ne gryke perroi ku pjeset anesore jane skarpata te thella dhe nuk eshte e mundur hyrja ne vend depozitim (nga njerezit apo kafshet), ne pjesen e poshtme eshte ndertuar nje prite me gabjona rrjete teli qe te mbaje mbetjet mos depertojne ne perrua mbetje te cilat rreshqasin ne pjesen e skarpatit, nga ana e sipërme hidhen mbetjet urbane dhe pjesa qe arrijne ne fund ndalohen nga prita e ndertuar per kete funksjon, pjesa e sipërme jugore e vend depozitimit nga behet dhe hedhja e mbetjeve ne vend depozitim eshte e rrethuar, per mbrojtjen dhe ndalimin e hyrjes se personave te pa autorizur apo kafshe qe mund te afrohen ne vend depozitim, vend depozitimi i mbetjeve urbane ruhet me roje.

Nuk eshte vend i pershtatshem per nje vend-depozitim te mbetjeve urbane duhet te punohet per te gjetur nje vend te pranueshem pasi dhe sic eshte cilesuar dhe me lart eshte ne nje gryke perroi dhe pse i thate por ka ndikimin e tij ne sjelljet e ujit ne vazhdimesi.

Bashkia Librazhd duke e pasur nje problem hedhjen e mbetjeve ne kete vend-depozitim ne vazhdim eshte ne bisedime qe mbetjet urbane ti trasferoje ne incineratorin e Elbasan. Vend-depozitimi qe kishim po behet rehabilitimi i tij rrethim total mbulimin i mbetjeve me inerte si dhe mbjelljen me peme per ta reabilituar ne menyre dhe sipas kriterëve kete zone.

Formacionet e ketyre dy shpateve jane shtresa sedimentare ranore jo te cimentuara mire dhe per pasoje jene ne aktivitet te vazhdueshem ne gerryerje, duke krijuar probleme ne vazhdimin e depozitimit te mbetjeve ne shtresat e fundme duke mos lejuar krijimin e shtresave te qendrueshme per sistemimin ne vazhdueshmeri te tyre. Pjerresia e ketyre shpateve nuk lejon nderhyrje per marjen e masave per sistemimin afatgjate per te qene i qendrueshem ky vend depozitim.

Risqet per mjedisin jane pasi ne te ardhmen mund te rriten gerryerjet dhe te gjitha lengjet qe mund te dalin nga dekompozimi i mbetjeve vazhdojne ne rrjedhen e ketij perroi ku kalojne ne nje nga lagjet(zone urbane) e qytetit te librazhdit duke vazhduar deri ne derdhjen ne lume.

Pas miratimit te transportimit te mbetjeve urbane , direkt per incineratorin Elbasan, del i nevojshem rehabilitimi i ish- vendgrumbullimit te mbetjeve urbane, tek Rrypezat e Lushit prane rruges Librazhd- Librazhd Qender .

Rehabilitimi parashikon ndertimin e nje prite ne pjesen fundore per mos lejimin e transportimit te ketyre mbetjeve per ne pjesen e poshteme, transportimin dhe heqjen e te gjitha mbetjeve urbane ne vende te frumbulluara larg zones ku do te rehabilitohet dhe rrethohet , mbushjen dhe mbulimin me dhe te shpateve te perroit, mbjelljen me peme, rrethimin e zones .

Fillimisht dhe te hiqen te gjitha mbetjet qe ndodhen ne nje zone jashte vendit ku eshte percaktuar per tu rrethuar dhe mbjelle me peme. Keto mbetje do te transportohen ne nje vend te pershtatshme.

Me pas do te ndertohet shtesa e murit gabion mbi ate ekzistues me qellim qe mbetjet te mos kalojne ne pjesen e poshteme.

Me pas do te merret material dheu per mbushje ne zonen afer . , do te mbulohet zona komplet, dhe me pas do te rrethohet. Mbjellja e pemeve do te perfundoje kete process rehabilitimi. Ne perfundim te punimeve ne zone nuk duhet te kete gjurme te mbetjeve urbane te hedhura me pare.



Sistemi i vend depozitimit te mbetjeve urba kerkon nderhyrjet si me poshte;

Heqje mbeturina jashte zones

Transport Dheu per mbulim

Rrethim Kolona+rrjete teli

Rrafshim skarpate

Prite malore me gabiona

Mbjellje peme pyjore

Keto nderhyrje ne vend-depozitim jane parashikuar duke pasur parasysh kushtet ligjore per vend-depozitimet qe mbyllen per rehabilitimin e siperfaqes dhe kthimin ne gjendjen e meparshme duke e

mbuluar me inerte (dhe), rrethim dhe mbjelljen e pemeve per rehabilitim te gjithe siperfaqes dhe rikthim ne gjendje te meparshme .

Çdo ndryshim ne zerat te punimeve do te behet me pelqimin e investitorit Bashkia Librazhd

PUNOI
ZYRA PROJEKTEVE, INVESTIMEVE

LIBRAZHD SHKURT 2019